

PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM

MAQEDONIA E VERIUT QYTETARËT SHFAQIN SHQETËSIME PËR DEMOKRACINË, INTEGRIMIN EVROPIAN, RIMËKËMBJEN EKONOMIKE

Sfidat përfshijnë KOVID-19, besimin në qeveri, dhe ndikimin e huaj joliberal

SHKUP, 12 Gusht – Një pjesë e madhe e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut (64%) besojnë se vendi po lëviz në drejtim të gabuar.

Në hulumtimin e fundit të mendimit publik të Institutit Nacional Demokratik, qytetarët në Maqedoninë e Veriut ishin anketuar për temat që lidhen me demokracinë, qeverisjen dhe përshtypjen për KOVID-19, gjeopolitikën, dhe dezinformimin.

Një shumicë e vogël në Maqedoninë e Veriut (52%) shohin regres në demokraci. Pesëdhjetë e tetë përqind (58%) e shohin demokracinë si sistem të preferuar të qeverisë por janë skeptik se parimet themelore siç është barazia para ligjit janë të arritshme. Pesëdhjetë e gjashtë përqind (56%) e të anketuarve i japin përparësi cilësisë të jetës mbi standardet demokratike. Paradoksalisht, 72% përqafojnë pikëpamjet pozitive si për qeverisjen demokratike ashtu edhe për udhëheqjen “me dorë të fortë.”

Perspektiva e ekonomisë/vendeve të punës (37%) si dhe shëndetësia/KOVID-19 (21%) mbesin shqetësimet kryesore për të anketuarit, ndërsa mungesa e besimit në gjyqësor (67%) dhe prokurorinë publike (63%) vazhdon edhe më tej.

“Qytetarët nuk kanë besim te politikanët, me 53% të të anketuarve që shprehen se nuk i besojnë “askujt” dhe kërkojnë që udhëheqësit të rrisin ekonominë, dhe të përmirësojnë kujdesin shëndetësor” ka thënë Robert Skot Heaslet, Drejtori i NDI në Maqedoninë e Veriut, duke shtuar se *“shqetësimet për mosndëshkueshmërinë politike dhe vonesat për anëtarësim në BE kontribuojnë në perceptimet e dobëta për perspektivën e shtetit dhe kapacitetet demokratike.”*

Mbështetja për Bashkimin Evropian është dobësuar në Maqedoninë e Veriut. Edhe pse 67 përqind e të anketuarve sinjalizuan se do të votonin për anëtarësimin në BE, perceptimet për BE-në janë tendosur, me 19% që sinjalizonë se kundërshtojnë anëtarësimin në BE – nga 10% që ishte në vitin 2018.

Mbështetja për aleancën e NATO-s mbetet e fuqishme me 63 përqind (64% në vitin 2018), ndërsa kundërshtimi për aleancën ushtarake është rritur në 24%, një rritje për nëntë përqind nga viti 2018.

Marrë në përgjithësi, ndërmjet të anketuarve është rritur favorizueshmëria (mbështetja në favor) për Turqinë, Rusinë, Shtetet e Bashkuara dhe Kinën në krahasim me vlerësimet e favorizueshmërisë të vitit 2018. Turqia dhe Rusia kanë ngritjen më të lartë të favorizueshmërisë për momentin me 52% respektivisht 48%, që është rritje nga 42% respektivisht 32%. Vlerësimet e favorizueshmërisë të SHBA-ve (43%) dhe Kinës (38%) janë më të ulëta.

Në lidhje me KOVID-19, qytetarët e anketuar janë personalisht të shqetësuar për KOVID-19. Një shumicë e konsideruar e të anketuarve janë “shumë” të shqetësuar për pandeminë KOVID-19, dhe qeveria ka marrë nota të dobëta për politikën dhe komunikimet e kufizimeve për KOVID-19, edhe pse të dhënat qeveritare për KOVID-19 janë të besueshme.

Tetëdhjetë e shtatë (87) përqind e qytetarëve të anketuar besojnë se ka dezinformata në media. Edhe pse 68% e të anketuarve kanë gjetur mediat sociale të besueshme, ka një mbështetje tek miqtë, familja, dhe kolegët për informatat. Facebook, Instagram dhe YouTube janë kryesisht platformat e preferuara për informata, por të anketuarit preferojnë që të diskutojnë politikën dhe lajmet personalisht në vend se në internet.

Ky hulumtim është porositur nga NDI dhe është realizuar në Maqedoninë e Veriut nga Ipsos në muajt Mars-Prill të vitit 2021 me një kampion përfaqësues (n=2410) dhe marzhë gabimi +/-2% përmes intervistave telefonike dhe në internet CAPI dhe CAWI. Hulumtimi është financuar nga Agjencia e SHBA-së për Zhvillimin Ndërkombëtar. Gjetjet nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e NDI, USAID apo Qeverisë të SHBA-së.